



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**KURRIKULA PËR SHKOLLAT ME DREJTIM
TË ORIENTUAR GJUHËT E HUAJA**

ARSIMI I MESËM I LARTË

DEGA: GJUHËT E HUAJA

LËNDA: GJUHË E HUAJ E DYTË

KLASA: X

Tiranë, 2016



I. Hyrje

Gjuha e huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, etj.) bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tyre personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Mësimi i gjuhës shqipe dhe i gjuhëve të huaja i ndihmon nxënësit që të bëhen individë të pavarur, të lirë, të kulturuar, mendimtarë kritikë dhe krijues, njerëz të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Me anë të leximit të teksteve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore (në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të huaj), nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë dhe vlerësojnë gjuhët, kulturën kombëtare dhe botërore.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën, kuriozitetin dhe besimin e nxënësve për t’u bërë komunikues të mirë, lexues aktivë e të pavarur dhe shkruar të saktë, origjinal dhe krijues. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë, synojnë të përmbushin pesë kompetencat: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit dhe përdorimi i drejtë i gjuhës.

Kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Letërsi, Gjuhë e huaj e parë, Gjuhë e huaj e dytë.

Gjuha shqipe mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës, nga klasa përgatitore deri në klasën XII.

Gjuha e huaj e parë fillon në shkallën e dytë (klasa III) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).

Gjuha e huaj e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa VI) dhe vazhdon deri në shkallën e gjashtë (klasa XII). Si gjuhë e huaj e dytë (**niveli A1+**) mund të jetë: gjuha frënge, gjuha italiane, gjuha angleze, gjuha gjermane, spanjolle etj.

Programi i gjuhës së huaj ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të fushës. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe kompetencave të fushës, nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj do të realizohen temat ndërkurrikulare të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe tregun e punës.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës së huaj me fushat e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të fushës. Këto njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime janë klasifikuar sipas disa tematikave.

Kompetencat përcaktohen si njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit mësimor.

- **Njohuri** është a) një e vërtetë e arsyetuar dhe e provuar sipas kriterëve të përcaktuara, e kodifikuar në tekstet akademike e ato shkollore apo në vepra të specializuara si produkt i një ose disa dijetarëve apo praktikienëve. b) ndërtim mendor i realizuar nga personi gjatë bashkëveprimit me mjedisin ose nga vetreflektimi për t'u bërë pjesë e trashëgimisë njohëse të tij, si p.sh.: njohuri për llojet e teksteve, njohuri gramatikore, njohuri për hartimin e një prezantimi etj.
- **Shkathtësi** është një kapacitet (mendor/fizik) i fituar për të arritur rezultatet e parashikuara, shpesh me shpenzim minimal të kohës ose energjisë, ose të të dyjave bashkë. Shkathtësia mund të jetë e përgjithshme ose e veçantë, si: të kuptuarit, të interpretuarit, të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese, zgjidhja e problemeve etj.
- **Qëndrimet** janë një mënyrë e përcaktuar e të menduarit, opinioneve dhe ndjenjave ndaj diçkaje, një ideje, personi ose situatë dhe që ndikojnë në sjelljen e individit.. Qëndrimet ndikohen nga njohuritë dhe vlerat dhe janë zakonisht shkaktare të sjelljeve (edhe pse lidhjet mes qëndrimeve dhe sjelljeve nuk janë drejtvizore). **Vlerat** janë bindje që ruhen thellë lidhur me çfarë është e rëndësishme ose e dëshirueshme. Ajo shprehet nëpërmjet qëndrimeve dhe veprimeve praktike të personave. Disa vlera dhe qëndrime janë: respektimi i rregullave të etikës gjatë të folurit, shmangia e fyerjeve dhe paragjykimëve, si dhe formave e tjera denigruese të gjuhës, shpirti i iniciativës, serioziteti, vetëbesimi etj.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të lëndës ka nisur që në arsimin bazë. Në këtë nivel arsimit nxënësit janë pajisur me njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për jetën dhe tregun e punës. Mirëpo kompetenca zhvillohet vazhdimisht, nuk ka pikëmbërritje (zhvillohet gjatë gjithë jetës).

I. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË GJUHËS SË HUAJ

Hartimi i programit lëndor mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor për shkollën e mesme të gjuhëve të huaja. Ky program shoqërohet me udhëzues dhe dokumente të tjera në ndihmë të mësuesve dhe hartuesve të teksteve mësimore.

Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, prindërit dhe komuniteti, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

Mësuesit do ta përdorin programin e gjuhës së huaj për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të nxënë nxënësit dhe se si duhet të ndërtojnë mësimdhënien për të pajisur nxënësit me kompetencat kyçe dhe të lëndës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit.

Autorët e teksteve do ta përdorin programin e gjuhës së huaj për të hartuar tekste që janë në funksion të realizimit të tij. Leximi i kujdesshëm i programit për çdo shkallë dhe klasë do t'i ndihmojë për të siguruar koherencën dhe për të shmangur ngarkesën e panevojshme.

Prindërit dhe komuniteti nëpërmjet programit mund të informohen për kompetencat që duhet të zotërojnë nxënësit e tyre në lëndën e gjuhës së huaj.

Specialistët e arsimit mund ta përdorin programin e gjuhës së huaj për qëllime inspektimi, monitorimi vlerësimi, studimi etj.


Fakultetet e mësuesisë mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre, me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Programi i gjuhës së huaj të dytë për shkollën e mesme të gjuhëve të huaja ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës, të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë, dhe tregun e punës.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës së huaj me fushat dhe lëndët e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës. Këto njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime janë klasifikuar sipas disa tematikave. Po kështu, në program janë sugjeruar edhe orët mësimore për çdo kompetencë.

Diagrami i mëposhtëm paraqet organizimin e programit.



1. Qëllimet e programit të lëndës “Gjuha e huaj e dytë” për shkollën e mesme të gjuhëve të huaja

Në kontekstin e sotëm social e politik ku Shqipëria aspirojnë të futet në Evropë dhe tendenca kryesore është krijimi i një mjedisi plurilinguist e multikulturor, gjuha e huaj ka një mision të veçantë. Ajo do të ndihmojë në shkëmbimet kulturore midis vendeve, në zhvendosjet e udhëtimet për motive të ndryshme. Programi i klasës 10-të për gjuhën e huaj të dytë për shkollën e mesme të gjuhëve të huaja parashikon sensibilizimin dhe hyrjen në një gjuhë dhe kulturë të re, në mënyrë që nxënësi të mund të zbulojë, të krahasojë dhe të përvetësojë shkallë-shkallë njohuri gjuhësore e social -kulturore duke siguruar përveç mësimin të gjuhës edhe përfundimin e qëndrimeve dhe sjelljeve të caktuara që inkurajojnë zhvillimin e individualitetit të nxënës/it,-es respektimin e diversitetit kulturor dhe të normave të ndryshme morale e zakonore duke lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimet gjuhësore në të ardhmen. Duke pasur parasysh se nxënësit e klasës 10, në fakt janë fillestarë të rritur që mbartin tashmë njohuri të shumta mbi botën ndonëse sipas përshkruesve të aftësive të *Kuadrit të Përgjithshëm të Referencave* ky program synon të realizojë nivelin **A1+, nivel elementar**, pritshmëritë e tyre dhe të mësuesit të gjuhës së huaj janë më të larta se për të njëjtin nivel të vegjëlit.

Në fund të klasës së dhjetë nxënësi shprehet për veten dhe botën rreth tij me fraza të thjeshta, mbi tema të njohura. Ai zgjeron njohuritë mbi kulturën e vendeve gjuhën e të cili ai mëson, duke zgjeruar me tej njohuritë e tij të përgjithshme.

Interesat dhe tematikat e programit u përgjigjen shkallës së ndërgjegjësimit të nxënësve për domosdoshmërinë e mësimin të gjuhës së huaj. Ata e dinë se nëpërmjet përdorimit të gjuhës së huaj mund të studiojnë apo më vonë të punësohen në një vend të Komunitetit Evropian.

Kështu gjuha e huaj kthehet në një instrument për të mësuar që pasuron aftësitë konjitive. Përvetësimi i gjuhës së huaj do të ndihmonte jo vetëm pasurimin dhe lulëzimin e individualitetit të nxënës/it,-es por edhe ndërtimin e qëndrimeve dhe sjelljeve etike që i shërbejnë komunitetit dhe krijojnë një qytetar të ri.

Programi i klasës 10 për gjuhën e huaj të dytë për shkollën e mesme të gjuhëve të huaja ashtu sikundër edhe programet e tjera, ka karakter tematik dhe përmban funksione të komunikimit si dhe njohuri gramatikore. Ky program synon mësimin e gjuhës nëpërmjet integritit të katër aftësive kyç (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit, të shkruarit). Duke iu referuar kurrikulës kombëtare dhe udhëzimeve

të Kuadrit të Përgjithshëm Evropian të Referencave temat duhet të përkojnë me interesat e nxënësve.


2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës

Realizimi i kompetencave kyçe të kornizës kurrikulare gjatë procesit mësimor kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit. Kur nxënësi përmbush kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë prezantimeve të ndryshme në orët mësimore të kompetencës së të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe realizon kështu edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës ku bën pjesë lënda e gjuhës së huaj, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, shoqëri dhe punë.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës mësuesi ndjek këto hapa:

-) përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
-) përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
-) planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
-) kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për fushën “Gjuhët dhe komunikimi”.

Diagrami i mëposhtëm konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës.



Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj, si gjuhë e huaj e dytë kl. 10, për shkollën e mesme të gjuhëve të huaja. Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyçe. Këto rezultate realizohen nëpërmjet fushave të të nxënit. Natyrisht, secila fushë dhe lëndë mund të kontribuojë në disa rezultate të nxëni. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” ndihmon realizimin e të gjitha kompetencave, por më së shumti në kompetencën e komunikimit dhe të të shprehurit. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj, në klasën e dhjetë.

Klasa X

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Nxënësi:

-)] shpreh përjetimet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit dhe gjatë dëgjimit të një filmi, dokumentari, ekspozite, dramatizimi, recitimi etj. në njërën nga format shprehëse (me gojë, me shkrim, vizatim, mimikë, lëvizje etj.);
-)] dëgjon me vëmendje prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim me fjali të thjeshta, mbi tema të njohura, me kusht që bashkëfolësi të jetë i gatshëm të përsërisë apo riformulojë frazat e tij;
-)] lexon saktë me zë një tekst të shkurtër me fjali të njohura dhe tematikë nga jeta e përditshme;
-)] identifikon personazhet kryesore të një tregimi, filmi, rime etj.;
-)] shpreh me gojë dhe me shkrim fjali të thjeshta në gjuhën e huaj dhe i përkthen në gjuhën amtare;
-)] shkruan një kartolinë të shkurtër e të thjeshtë, një urim, plotëson një pyetësor me detaje personale.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

-) identifikon, personazhet, kohën, vendin etj.;
-) shprehet pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

Kompetenca e të nxënës

Nxënësi:

-) ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim / detyrë, që kërkohet .
-) pyet dhe përgjigjet lidhur me tematika nga jeta e përditshme, me një fjalor të thjeshtë;
-) grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal;
-) shfrytëzon burime të ndryshme informacioni për përgatitjen e një teme të dhënë;
-) krahason përparimin e tij, me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një veprimtarie të caktuar;
-) përdor portofolin personal si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara, duke hartuar një plan pune me hapa konkrete për përmirësim.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi:

- Ñ përgatit një plan të thjeshtë ditor me shkrim, për dy- tri aktivitete ditore, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrës;
- Ñ identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi;
- Ñ përgatit një autobiografi ku prezanton veten, të dhënat personale dhe prirjet, që ka për fusha të caktuara, si dhe profesionin e dëshiruar, me një gjuhë të thjeshtë;

Ñ diskuton me një fjalor të thjeshtë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë, në shkollë dhe mjedise të tjera në një situatë të caktuar.

Kompetenca personale

Nxënësi:

Ñ bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.

Ñ bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët (projekti/ aktiviteti në bazë klase /shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca qytetare

Nxënësi:

Ñ përcakton rregullat e punës në grup në bashkëpunim me anëtarët e grupit;

Ñ shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit, duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët, për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Kompetenca digjitale

Nxënësi:

Ñ identifikon personazhet, kohën, vendin e një teksti të shkurtër të dëgjuar (nga mjetet audio-vizuale), të shprehur qartë dhe ngadalë;

Ñ realizon punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tij;

Ñ përdor teknologjinë digjitale për të gjetur informacionin e nevojshëm.

3. Lidhja e gjuhës së huaj me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënit të cilat i ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë, me jetën dhe interesat e tyre. në kornizën kurrikulare dhe në kurrikulat bërthamë janë përcaktuar temat ndërkurrikulare, të cilat janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Të drejtat e njeriut
- Vendimmarrja morale
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Mjedisi
- Ndërvarësia
- Bashkëjetesa paqësore

Gjuha e huaj zhvillon te nxënësit njohjen e vlerësimin e kulturës botërore dhe kultivon identitetin dhe krenarinë kombëtare. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj., mund të realizohen gjatë orëve mësimore të kompetencës së të folurit. Mësuesi mund të krijojë edhe situata mësimore gjatë të cilave nxënësit shprehen në forma të ndryshme: ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë çështjet e mësipërme. Punët në grupe dhe projektet që zhvillohen në lëndën e gjuhës së huaj, ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

4. Kompetencat e fushës

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” realizon pesë kompetenca të cilat janë: të dëgjuarit e teksteve të ndryshme; të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar; të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare; të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale; përdorimi i drejtë i gjuhës.

Përshkrimi i kompetencave të fushës

a) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësit marrin njohuri, zhvillojnë qëndrime dhe vlera, si dhe zbatojnë aftësi dhe shkathtësi duke dëgjuar tekste të shkruara apo të folura. Më konkretisht, nxënësit kuptojnë se sjellja dhe qëndrimet e duhura gjatë të dëgjuarit ndikojnë pozitivisht te të tjerët. Ata dallojnë disa cilësi të zërit të folësit si: intonacioni, ritmi, theksi, volumi i zërit.

b) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Nxënësit përdorin drejt gjuhën standarde gjatë folurit, në nivel bazë. Ata diskutojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët gjatë punës në grup.

c) Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Nxënësit dallojnë të dhëna personale, në një formular ose pyetësor të thjeshtë, si dhe mesazhe ose komente të thjeshta mbi detyrën, punën etj.

d) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësit shkruajnë fjali të thjeshta për qëllime personale dhe funksionale.

f) Përdorimi i drejtë i gjuhës

Që nxënësit të flasin dhe të shkruajnë në mënyrën e duhur, ata duhet të zotërojnë njohuri e të demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës. Kështu, nxënësit dallojnë pjesët e ndryshme, kryesore të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit; dallojnë llojet e ndryshme të fjalive; përdorin gjuhën standarde elementare.

5. Ndarja e orëve mësimore

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për gjuhën e huaj të dytë për shkollën e mesme të gjuhëve të huaja.

Orët Mësimore 36 javë x 4 orë = 144 orë vjetore

Koha mësimore për çdo kompetencë përdoret: **60- 70%** për njohuri të reja dhe **30 -40 %** përpunim njohurish, projekte, vlerësim, etj. Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10% të orëve të një kompetence.

Programi i gjuhës së huaj përcakton raportin: Komunikim, Formim kulturor dhe Formimi gjuhësor. Kjo krijon mundësi për formimin e aftësive dhe shprehive afatgjatë tek nxënësit.

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në kapituj e njësi mësimore) objektivat sipas kompetencave të përshkruara më lart ndërthuren me njëra-tjetrën dhe mund të zënë vend aty ku përdoruesi e sheh më të arsyeshme për t'i zbatuar. Konceptimi i kapitujve të tekstit dhe njësive mësimore është e drejtë dhe detyrë e autorit të tekstit dhe mësuesit. E rëndësishme është në këtë rast, që zbatuesit e programit të jenë të vëmendshëm në realizimin cilësor të të gjitha objektivave të përcaktuara në këtë program.

Shkalla e Pestë	Komunikim dhe formim kulturor	Formimi gjuhësor	Orë/vit
Klasa e dhjetë	90 orë	54 orë	144 orë

Koha mësimore për çdo kompetencë përdoret: **60- 70%** për njohuri të reja dhe **30 -40 %** përpunim njohurish, projekte, vlerësim, etj. Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10% të orëve të një kompetence.

Kompetenca: Të dëgjuarit

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi demonstroi sjellje dhe qëndrime të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si: vëmendje, pëlqim dhe interes. Ai dëgjon dhe kupton fjalë e tekste të shkurtra (nga jeta e përditshme, nëse flitet ngadalë dhe qartë), demonstroi se i ka kuptuar ato, si dhe shpreh opinionet e tij rreth asaj që dëgjon.

Nxënësi demonstroi njohuri, aftësi, qëndrime mbi marrëdhëniet komunikuese dhe kulturore në situata të thjeshta, të njohura më parë, për të plotësuar nevojat konkrete. Nëpërmjet situatave të ndryshme, tërheqëse për moshën, realizohet zhvillimi i gjithanshëm i nxënësit në aspektin njohës, gjuhësor, emocional dhe kulturor. Nxënësi prezanton dhe ndërvepron me të tjerët për plotësimin e nevojave dhe interesave për familjen, shkollën dhe shoqërinë, si edhe për kulturën e vendeve të ndryshme.

Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të dëgjuarit

Nxënësi:

- Ñ tregon pikat kryesore të një pjese të shkurtër me një gjuhë shumë të thjeshtë;
 - Ñ shpreh kuptimin e dialogëve dhe mesazheve të reja, të përcjella me gjuhë të thjeshtë;
 - Ñ reagon ndaj pikave kryesore dhe hollësirave të rëndësishme.
- (ai mund të ketë nevojë për përsëritje)

Njohuritë për realizimin e kompetencës

-) Alfabeti i gjuhës së huaj nëpërmjet pjesëve të thjeshta të vjershave, këngëve, lojërave etj.
-) Fjalë dhe përshëndetje të thjeshta të jetës së përditshme (*Mirëdita!; Si je?*).

Aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e kompetencës

Të dëgjuarit

Nxënësi:

-) dëgjon dhe reagon ndaj një ligjërate të shkurtër, të shqiptuar qartë dhe ngadalë që i drejtohet atij në një bisedë të përditshme, me ndihmën e përsëritjes së fjalëve e shprehjeve;

<ul style="list-style-type: none">) Pyetje të thjeshta rreth njerëzve të njohur) Ditët e javës) Udhëzime shumë të thjeshta (<i>hap librin, mbyll derën, hyr, dil, ulu, ngrihu, fol, përgjigju etj.</i>) 	<ul style="list-style-type: none">) identifikon objekte të ndryshme, kur ato dëgjoen, përmenden apo tregohen;) identifikon udhëzime të thjeshta në klasë dhe jashtë saj;) reagon përmes veprimtarive fizike ndaj orientimeve, udhëzimeve dhe veprimeve të mësuesit apo të njerëzve që e rrethojnë;
<p>Të dëgjuarit</p> <ul style="list-style-type: none">) Studime tekstesh të tilla si: gjëegjëza, dialogë të shkurtër, dramatizime të ndryshme, shfaqje, rregulla praktike etj. 	<ul style="list-style-type: none">) dëgjon dhe reagon ndaj përshëndetjeve dhe urdhrave;) dallon dhe kupton edhe pse me vështirësi thelbin e bisedave rreth temave të jetës së përditshme;) ndjek udhëzime të thjeshta që tregojnë drejtim, si dhe pikat orientuese etj.;) reagon ndaj udhëzimeve të drejtuara në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë;) kupton në përgjithësi përmbajtjen e informacionit në materiale të regjistruara (CD, kaseta audio ose video), tema e të cilave është e interesit personal dhe me gjuhë të qartë dhe standarde;) dallon çmimet, numrat, orën etj.

Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës

Nxënësi:

- J shfaq sjellje të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si p.sh.: ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon; nuk e ndërpret tjetrin, kur është duke folur; e sheh në sy personin gjatë kohës që flet; shpreh pëlqim dhe interes ndaj asaj që dëgjon.

Kompetenca: Të folurit

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi shqipton saktë dhe me intonacionin e duhur fjalët. Ai shpreh saktë dhe kuptueshëm mendimet e tij, shoqëron të folurin edhe me elemente jo verbale, bashkëpunon në grup, si dhe merr pjesë në lojëra me role. Nxënësi merr pjesë në biseda të shkurtra, kërkon dhe përcjell informacion, duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve për përjetime aktuale.

Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të folurit

Nxënësi:

- J komunikon në mënyrë të thjeshtë, kur folësi është i qartë në bashkëbisedim;
- J flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, fjali të thjeshta e të shkurtra;
- J diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta;
- J përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve dhe të ekspozitave në klasë;
- J merr pjesë në lojë me role.

Njohuritë për realizimin e kompetencës

Aftësitë dhe shkathhtësitë për realizimin e kompetencës

<p>) Krijimi i një bazë shprehish, aftësish dhe qëndrimesh të nevojshme për mësimin e gjuhës së huaj të dytë</p> <p>) Alfabeti i gjuhës së huaj nëpërmjet pjesëve të thjeshta të rimave, vjershave, këngëve dhe lojërave etj.</p> <p>) Emri, moshë, vendbanimi</p> <p>) Përshkrim me një fjalor shumë të thjeshtë për njerëzit e njohur</p> <p>) Përdorimi i formulave më të thjeshta të mirësjelljes (<i>Të lutem; Më fal; Mirëdita</i>)</p> <p>) Numrat nga 1-20</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>) shqipton saktë dhe me intonacionin e me theksin e duhur fjalët dhe fjalitë;</p> <p>) reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendësh;</p> <p>) merr pjesë lojë me role;</p> <p>) shoqëron të folurin me shprehjen e duhur të fytyrës dhe gjestet e përshtatshme;</p> <p>) përdor gjatë prezantimeve të tij edhe elemente të tilla si: foto dhe piktura;</p> <p>) pyet, përgjigjet, shpreh mendime, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë (kryesisht brenda klasës).</p> <p><i>Të folurit ndërveprues</i></p> <p>Nxënësi:</p> <p>) bën pyetje të thjeshta për atë çfarë sheh ose dëgjon duke shprehur dëshirat, ndjenjat dhe parapëlqimet;</p> <p>) pyet dhe kërkon sende që i nevojiten për të kryer një punë;</p> <p>) pyet dhe u përgjigjet pyetjeve të thjeshta për veten, familjen, shkollën dhe vendbanimin.</p> <p><i>Prodhimi i të folurit</i></p> <p>Nxënësi:</p> <p>) prezanton veten duke përdorur fjali të thjeshta;</p> <p>) thotë emrin, moshën dhe vendbanimin;</p> <p>) flet thjesht për njerëzit e njohur dhe për familjen;</p>
--	---

	<ul style="list-style-type: none">) zhvillon një bisedë të thjeshtë e të drejtpërdrejtë mbi tema të njohura si p.sh., familja, shokët, shkolla, koha e lirë, edhe pse me vështirësi madje dhe me ndërhyrje nga bashkëfolësi;) merr pjesë në diskutime të thjeshta mbi tema të njohura, edhe pse me hezitime, shpesh duke riformuluar mendimin e tij;) jep përshtypjet e tij rreth një përvoje personale, duke përdorur fjalë të thjeshta dhe lidhëza për të treguar lidhjen logjike të ngjarjeve;) përshkruan mjedisin që e rrethon në shtëpi, klasë, shkollë etj.;) shpreh me mirësjellje aprovimin dhe mosaprovimin e udhëzimeve të dhëna në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë;) kërkon e transmeton informacion të thjeshtë, duke kërkuar dhe duke ndjekur udhëzimet përkatëse;) shprehet me një fjalor të thjeshtë, me një shqiptim të mirë e përgjithësisht të saktë mbi tema të përditshme si shkolla, udhëtimet etj.;) kërkon e jep sqarime në situata të parashikuara;) shpreh dhe kërkon mendimin personal në diskutime me shokët mbi tema të interesit të përbashkët, duke përdorur shprehje e fjalë të thjeshta.
Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të folurit (nuk fyen të tjerët, përdor fjalët dhe shprehjet e mirësjelljes). 	

Kompetenca: Të lexuarit

Përshkrimi i kompetencës	
<p>Nxënësi lexon dhe kupton tekste të thjeshta letrare dhe joletrare (lajmërimë, njoftime etj.). Ai përdor strategji të thjeshta për të kuptuar tekstin si: lidh tekstin me njohuritë e mëparshme, rilexon, kërkon përsëritje, pyet rreth paqartësive, mban shënime, bën nënvizime etj. Nxënësi demonstroi kuptimin e tekstit duke identifikuar personazhet, vendin, kohën, si dhe jep mendimet e tij rreth asaj që lexon. (<i>i pëlqen/nuk i pëlqen etj.</i>)</p>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të lexuarit	
Nxënësi:	
) përdor strategjitë e duhura për të lexuar tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë dhe paragrafin;	
) lexon me zë një tekst të shkurtër dhe identifikon personazhet kryesore, tregon funksionin e pjesëve plotësuese të tekstit (p.sh., foto, vizatim, pamje etj.);	
) jep përshtypjet e veta në lidhje me një tekst të shkurtër letrar (vjershë, përrallë,) dhe joletrar (kalendar, gjëgjëzë).	
Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës	
Njohuritë	Aftësitë dhe shkathtësitë
) Emërtimi i shkronjave të alfabetit	<i>Të lexuarit fillestar</i>
) Identifikimi i informacionit përmes figurave për anëtarë të familjes, shokët, lojërät etj.	Nxënësi:
) Të dhëna personale, emër, adresë, ditëlindje, në një formular ose pyetësor të thjeshtë.) kupton fjalë dhe shprehje të thjeshta e të njohura që kanë të bëjnë me njerëzit, moshën dhe vendin e banimit;
) Mesazhe, komente shumë të thjeshta mbi detyrat, punën etj.) kupton tekste të shkurtra, të thjeshta dhe të qarta në lidhje me interesat e tij dhe dallon fjalë dhe fraza të njohura e të mësuara më parë;

	<ul style="list-style-type: none">) kupton qartë udhëzimet e një pyetësi, formulari, duke dhënë një informacion bazë për veten dhe shokun;) kupton komandat më të rëndësishme të një programi kompjuterik, si: printim, ruajtje, kopjim etj.;) kupton mesazhe të shkurtra përmes emailit dhe letrës. <p><i>Të lexuarit për të kuptuar tekstin</i></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti, ose rreth fjalëve të panjohura për të (<i>Ku? Kur? Pse? Si ndodh kjo? Çfarë do të thotë?</i>);) rilexon tekstin për të kuptuar më mirë atë (kur është e nevojshme);) dallon të dhëna personale në një pyetësor të thjeshtë;) identifikon mesazhe, komente shumë të thjeshta mbi detyrat dhe punën e bërë.
Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) lexon me interes, emocion, dëshirë dhe me ndjenjë. 	

Kompetenca: Të shkruarit

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi shkruan një kartolinë urimi, të shkurtër dhe të thjeshtë. Nxënësi mund të sjellë detaje personale në një pyetësor, si dhe shkruan emrin, mbiemrin, kombësinë, adresën. Ai shkruan fjali të thjeshta dhe të shkurtra mbi tematika të njohura.

Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të shkruarit

Nxënësi:

-) shkruan për të komunikuar idetë e veta te të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive të shkurtra etj.;
-) shkruan tekste të thjeshta (urim, letër, kartolinë) sipas modeleve të dhëna.

Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës

Njohuritë	Aftësitë dhe shkathtësitë
<ul style="list-style-type: none">) Plotësim i të dhënave personale në një formular (emër, mbiemër, adresë)) Kopjimi i fjalëve dhe fjalive të shkurtra të marra nga teksti ose gjatë një ore mësimi në klasë) Ndërtimi i fjalive me anën e etiketave) Shkrimi i një kartoline të thjeshtë urimi (për ditëlindje, Vitin e Ri, Krishtlindje etj.)	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) dallon dhe zgjedh fjalë të përshtatshme për të plotësuar vende bosh në fjali apo fjalë të renditura në formë liste;) etiketon objekte rrethore;) formulon një kartolinë të thjeshtë urimi, duke përdorur fjalë ose fraza të shkurtra dhe standarde;) plotëson vende bosh me fjalë duke iu referuar figurave apo pikturave të njohura;) emërton një etiketë për një send të njohur.) përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të;

	<ul style="list-style-type: none">) shkruan tekste të shkurtra si: një urim, një kartolinë, drejtuar një shoku duke përdorur një model të thjeshtë;) përshkruan një ngjarje të vërtetë, me fjalor të thjeshtë për shkrimet treguese.) mban shënime të shkurtra, për të lënë një mesazh.) plotëson një pyetësor me informacion rreth shkollimit, moshës, kombësisë dhe interesave të tij.
Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) mban gjatë të shkruarit pozicionin e duhur të trupit, dorës, fletores ose fletës ku shkruan. 	

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës

<p>Përshkrimi i kompetencës</p> <p>Nxënësi dallon fjalitë në një tekst. Ai zhvendos, shton ose heq fjalë në një fjali pa e prishur kuptimin e saj. Nxënësi dallon fjalitë pyetëse dhe dëftore, pohore dhe mohore si dhe vendos shenjat e pikësimit në fund të tyre. Ai nis të dallojë emrin, mbiemrin, foljen, përemrin, nyjat shquese dhe jo shquese, numërorin.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetencën e përdorimit të drejtë të gjuhës</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) dallon emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh në numrin njëjës dhe shumës (shumësi i rregullt);) zgjedhon folje të rregullta (foljet jam/kam etj.) në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme, sipas modeleve të dhëna;) dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore, pohore, pyetëse dhe mohore, duke respektuar shenjat e pikësimit;

<ul style="list-style-type: none">) dallon mbiemrin si fjalë që tregon cilësi të emrit;) gjen dhe formon fjali me përemra vetorë dhe me numërorë;) dallon nyjat shquese dhe jo shquese. 	
Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencave lëndës	
Njohuritë	Aftësitë dhe shkathtësitë
<ul style="list-style-type: none">) Emri) Përemri (vetor njëjës e shumës, përemri dëftor etj.)) Mbiemri) Nyjat shquese dhe jo shquese) Shumësi i emrave të rregullt) Foljet <i>jam, kam</i> dhe disa folje të rregullta në kohën e tashme) Parafjalët <i>në, mbi</i> etj. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) dallon fjalitë në një tekst;) ndërton fjali me etiketa;) dallon fjalët që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh;) dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore;) dallon emrin në numrin njëjës dhe në numrin shumës (shumësi i rregullt);) gjen në një tekst fjalët që tregojnë veprim;) zgjedhon foljet <i>jam, kam</i> dhe disa folje të rregullta në kohën e tashme;) formon fjali me përemrat vetorë: <i>unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato</i>.
Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) paraqet dhe komunikon me gjuhë të thjeshtë mendimet e tij;) demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;) demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;) respekton përpjekjet personale dhe ato në grup. 	

6. Udhëzime metodologjike

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre do të shërbejë për zhvillimin gjuhësor të nxënësve.

Mësuesit duhet të përditësojnë çdo ditë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësit dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë të suksesshëm dhe aktivë në jetën e përditshme. Metoda, strategji dhe teknika të tilla, si: *diskutim për njohuritë paraprake, diagrami piramidial, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditaret e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen* etj. shërbejnë si nxitje për nxënësit në procesin e të nxënësve dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e të nxënësve. Mësimdhënia e gjuhës së huaj duhet të karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësit do të jenë në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces do të ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lënda e gjuhëve të huaja kërkon që nxënësit të nxënë konceptet, të zotërojnë shprehjet dhe të zbatojnë njohuritë gjuhësore. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies të cilat përshtaten me objektin e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve. Qëllimi i çdo strategjie të mësimdhënies është që çdo nxënës të mësojë dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore në mënyrë efektive.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit do të sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata do të përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarit bashkëveprues. Nxënësit gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh do të nxiten të punojnë së bashku.

Detyrat e përbashkëta do t'u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur dhe për të ndarë përvojat e tyre me njëri-tjetrin. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe do të nxisë tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe do të ndikojë në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

Integrimi

Linjat e programit: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe njohuri rreth sistemit gjuhësor do të trajtohen në mënyrë të integruar që të sigurohen lidhje kuptimplota mes tyre. Asnjëherë nuk mund të bëhen veprimtari vetëm për njërin nga linjat e programit. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe zhvillohen së bashku. Një lidhje e fortë ndërmjet këtyre linjave forcon cilësinë e të nxënësve.

Procesi i rimarrjes së njohurive

Aftësitë, njohuritë rreth sistemit gjuhësor, llojet e ndryshme të teksteve do të zhvillohen duke u rishikuar dhe rishqyrtuar vit pas viti, por në një nivel më të lartë vështirësie. Kjo do t'u mundësojë nxënësve të përparojnë nga niveli bazë në nivele më të larta të përdorimit të gjuhës.

7. Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi është një komponent themelor i programit të gjuhës së huaj të dytë, i cili shoqëron dijen e përfutur gjatë gjithë procesit mësimor. Vlerësimi i dijeve në këtë moshe mbështetet tek objektivat dhe standardet që përcakton ky program. Si rezultat, vlerësimi ka këto pikësnyime:

-) të nxisë nxënien dhe zhvillimin personal të nxënësve;
-) të identifikojë nxënës me nevoja dhe interesa të veçanta;
-) të monitorojë ecurinë e programit dhe të vlerësojë efikasitetin e tij;
-) të mbledhë të dhënat nga rezultatet e nxënësve sipas banchmark-ut te niveli A1+ për llogari të realizimeve të qëllimeve dhe të standardeve;

) të përcaktojë pritshmëritë në të ardhmen tek nxënësit e kësaj moshe, pavarësisht nga ndryshimet e tyre individuale, gjuhësore, emocionale, shoqërore dhe kulturore.

Për këtë moshë rëndësi ka vlerësimi pozitiv i nxënësit. Asgjë nuk është më nxitëse sesa suksesi i arritur dhe kjo arrihet vetëm duke e motivuar këtë moshë gjatë gjithë procesit të nxënies së dijeve në gjuhën e huaj të dytë.

Kur vlerësimi i gjithë procesit të mësimdhënies e të nxënies në klasën 10-të bëhet në përputhje me kushtet e programit, ai i ndihmon mësuesit:

) të diagnostikojnë pikat e dobëta dhe mundësitë e nxënësve;

) të vlerësojnë metodën e mësimdhënies;

) t'u tregojnë nxënësve nëse i kanë arritur objektivat.

Për vlerësimin e nxënësve, mësuesit duhet të mbështeten në disa parime bazë:

) Vlerësimi është pjesë thelbësore e procesit të mësimdhënies dhe të nxënies. Ai duhet të jetë një **veprimtari e planifikuar, e vijueshme** që ka lidhje të ngushtë si me programin, ashtu dhe me mësimdhënien.

) Vlerësimi duhet të **udhëhiqet nga rezultatet e synuara të të nxënies** të programit dhe të përdorë shumëllojshmëri strategjish dhe teknikash vlerësimi me pikësnyim arritjen e standardeve.

) **Planet e vlerësimit duhet t'u bëhen të ditura nxënësve dhe prindërve më parë në kohë**. Nxënësve duhet t'u jepen mundësitë për t'u përgatitur për vlerësim. Ndërsa prindërit duhet të vihen në dijeni për gjendjen reale të suksesit të nxënësve të tyre në shkollë.

) Vlerësimi duhet të jetë **i ndershëm dhe i paanshëm**. Ai duhet të jetë i ndjeshëm kundrejt situatave familjare, të klasës, të shkollës dhe të komunitetit; ai duhet të jetë i paanshëm. Nxënësve duhet t'u jepen mundësitë të demonstrojnë shkallën e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të tyre.

) Vlerësimi **duhet të jetë ndihmues për të gjithë nxënësit**. Ai duhet t'u japë atyre informacion pozitiv dhe nxitës për t'u përfshirë aktivisht në procesin e të nxënies.

Nëpërmjet vlerësimit mësuesit “zbulojnë” shkallën e përfutimit e të konsolidimit (nga ana e nxënësit) të njohurive, aftësive dhe shprehive të përfshira në këtë program.

Vlerësimi duhet të jetë:

- a. vlerësim i vazhdueshëm me gojë;
- b. vlerësim me shkrim.

Vlerësimi me shkrim dhe me gojë klasifikohet në:

-) Vlerësim formues, me anë të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënësit në formimin e tyre gjuhësor në përputhje me objektivat e caktuara.
-) Vlerësim diagnostikues, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe përvetësimin e materialit gjuhësor të dhënë më parë. Ai, gjithashtu, jep informacion për efektshmërinë e të nxënësit dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/nxënies.
-) Vlerësim i planifikuar mbi bazën e realizimit të objektivave të nënlinjave, pra në bazë kapitulli. Ky vlerësim bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës.
-) Vlerësim motivues, ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënësit për mësimin e gjuhës angleze. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor.

Vlerësimi përfundimtar është vlerësimi me notë që finalizon arritjet e objektivave të linjave dhe nënlinjave për këtë moshë.

Vetëvlerësimi është element i rëndësishëm në mësimin e gjuhës angleze për këtë moshë. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e tyre në vazhdimësi. Gjatë vetëvlerësimit në procesin mësimor ndiqen këta hapa:

-) Mësuesit diskutojnë me nxënësit atë që ata do të arrijnë në klasë;
-) Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas mësuesi dhe nxënësit bëjnë komentimin përfundimtar;
-) Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe duke marrë role të ndryshme, madje ndonjëherë dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit;

) Nxënësit mbajnë shënim arritjet e tyre duke përdorur edhe gjuhën amtare;

) Mësuesit bisedojnë me nxënësit individualisht dhe i tregojnë arritjet.

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Njohja e nxënësit me vetëvlerësimin e ndërgjegjëson atë të kuptojë më mirë problemet e të mësuarit dhe i jep mundësi të caktojë objektiva për të ardhmen.

Përveç testeve me shkrim, mësuesit mund të përdorin dhe forma të tjera për të testuar pjesëmarrjen dhe ecurinë e nxënësve në mësimin e gjuhës së huaj të dytë në shkollë, si:

) detyrat e shtëpisë;

) projektet kurrikulare dhe ndërlëndore;

) vrojtimit e mësuesit;

) listat e kontrollit;

) modelet dhe maketet;

) posterat;

) lojërat dhe kuicet;

) lojërat me role;

) portofolet.

Portofoli është një dokument kryesor për nxënësin, mësuesin dhe prindërit. Ai është një grumbullim sistematik i punëve të nxënësve dhe mundëson një vështrim krahasues të arritjeve të tyre për të nxitur përparimin e tyre. Punët e grumbulluara bëjnë një regjistrim në vazhdimësi të zhvillimit dhe të përparimit të nxënësve në përfundimin e njohurive, aftësive dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ai, gjithashtu, u jep nxënësve mundësinë të vetëvlerësohen dhe të reflektojnë në bazë të portofolit të tyre.

Vlerësimi përfundimtar i nxënësit bëhet me notë. Në këtë mesatare përfshihen notat e vlerësimeve me shkrim, me gojë, me projekte kurrikulare etj.